



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me: Priljeno:	08.07.2024	
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
15-470/03-32390		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

NR	
DATË	08.07.2024
PËR	Daut Azemi , Kryesues i Kuvendit Komunal Lipjan
NGA	Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
LËNDA	Kërkesë për procedim për pika të rendit të ditës në Kuvendin e Komunës




Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës ta parasheh në rend të ditës si dy pika të veçanta shqyrtimin - diskutimin e Raportit e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2023 dhe Planin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës kombëtare të Kosovës për vitin 2023 të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit si dhe shqyrtimin-diskutimin e Raportit vjetor të NJAB-së për vitin 2023.

Shtojcë:

1. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2023 dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës kombëtare të Kosovës për vitin 2023 të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit dhe
2. Raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit (KL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Lipjanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Mangësi në trajtimin e kërkesave për leje ndërtimore, leje mjedisore dhe legalizim.
- A2 Mangësi në përzgjedhje, monitorim dhe raportim nga përfituesit e subvencioneve.
- A3 Mangësi në zbatimin e procedurave në angazhimin e konsulentëve.
- B1 Urdhërblertjet pas pranimit të faturave.
- B2 Kosto shtesë si rezultat i pagesave nga vendimet gjyqësore / përmbarrimore.
- C1 Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve.
- A4 Parregullsi gjatë aplikimit të zbritjeve nga baza tatimore për pronat me banim parësor dhe përditësimin të informacionit për tatimpaguesit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Lipjanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Lipjanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Lipjanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet^a

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Përmirësimet duhet të zbatohen te: menaxhimi dhe implementimi i projekteve kapitale, klasifikimi e shpenzimeve në kategoritë përkatëse, menaxhimi i tatimit në pronë, llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme, proceset e subvencionimit dhe monitorimit të projekteve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Si rezultat i procedurave përbarimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën e shujtave sipas kontratës kolektive për personelin arsimor, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë 145,368 , nga të cilat 29,613 janë kosto shtesë në emër të kamatave, tarifave të përbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore

Ky raport ka rezultuar me dhjetë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, tre (3) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në trajtimin e kërkesave për leje ndërtimore, leje mjedisore dhe legalizim

Gjetja

Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim, neni 21, pika 4, specifikon se pas pranimit të kërkesës së pakompletuar për leje ndërtimore për ndërtim të kategorisë II ose III, organi kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve e njofton aplikuesin për hapat e nevojshëm që duhet t'i ndërmerret që ta kompletoj kërkesën. Nëse përmirësimet janë të nevojshme, aplikuesi i bën përmirësimet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve për ndërtimet e kategorisë II dhe III. Nëse aplikuesi nuk i përmbahet afateve pas njoftimit, organi kompetent mundet ta refuzoj kërkesën. Kjo kohë e shqyrtimit nuk do të ndikoj në afatin e organit kompetent për lëshimin e lejes sipas paragrafit 3. të këtij neni.

Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, neni 14, pika 3.1, specifikon se nëse organi kompetent vlerëson se aplikacioni është i kompletuar dhe ndërtimi pa leje kualifikohet për legalizim siç parashihet me këtë ligj, organi kompetent lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në kadastër dhe në RDPP brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas dorëzimit të aplikacionit të kompletuar nga aplikuesi.

UA nr. 01/2017 për dhënien e lejes ndërtimore, neni 6, pika 1, specifikon se, për marrjen e leje mjedisore, aplikuesi duhet t'i dorëzojë komunës kërkesën të cilës i bashkëngjitet raporti për leje mjedisore.

Nga auditimi i lëndëve kemi identifikuar se:

- Një kërkesë për leje ndërtimore kishte vonesa në shqyrtimin e aplikacionit për 40 ditë, derisa njoftimi për plotësim dokumentacioni ishte me 20 ditë vonesë,
- Shqyrtimi i një kërkesë për legalizim kishte vonesa gati 3 vite, dhe
- Për leje mjedisore komuna nuk aplikon kërkesën nga pala ashtu siç kërkohet me procedurat dhe udhëzuesin përkatës, por praktikon një kërkesë/dokument të brendshëm të përpiluar dhe nënshkruar nga vet zyrtarët e komunës e jo edhe nga aplikuesi.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve të brendshme të mangëta dhe mungesës së personelit të mjaftueshëm në shqyrtimin e lëndëve.

Ndikimi

Mangësitë aktuale ndikojnë negativisht në përmbushjen me kohë të shërbimeve komunale ndaj bizneseve dhe qytetarëve.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim shqyrtohen brenda afateve kohore ligjore, dhe se kërkesat për leje mjedisore të bëhen nga vet aplikuesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në përzgjedhje, monitorim dhe raportim nga përfituesit e subvencioneve**Gjetja**

Në thirrjen publike nr.05-453/01-38765, të datës 27.07.2023, dhe udhëzimin për aplikantët, është kërkuar nga aplikuesit formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë, vërtetimin nga ATK që vërteton se organizata nuk ka borxh publik apo ka ndonjë marrëveshje për shlyerjen e obligimeve, para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Në vendimet për ndarjen e mjeteve financiare për përfituesit individual nr. 453/01-41957, 400/04-41795 dhe 400/04-66447, neni 3, përcaktohet që përfituesi duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat t'i dorëzojë në DKRS më së largu deri me 25.12.2023 respektivisht 31.01.2024.

Te subvencionimi i klubit sportiv të volejbollit "Ulpiana" në vlerë 8,000€, përfituesi kishte ofruar vërtetimin tatimor me afat të skaduar, në deklaratën mbi financimin e dyfishtë nuk është specifikuar (shenjzuar) asnjëri nga opsionet nëse ka përfituar financim për të njëjtin projekt apo jo, dhe se vërtetimin nga gjykata e ka ofruar pas nënshkrimit të kontratës.

Gjithashtu, tre përfitues individual që ishin financuar nga komuna në vlerë total 5,300€, nuk kishin dorëzuar në komunë raportet narrative dhe financiare për shumën e përfituar.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme gjatë vlerësimit të kërkesave për subvencionim, si dhe papërgjegjshmëria e zyrtarëve përgjegjës për të mbikëqyrur implementimin dhe raportimin nga OJQ-të përfituese.

Ndikimi

Mungesa e kontrolleve adekuate lidhur me procesin e vlerësimit të aplikacioneve mund të ndikojë në subvencionimin e përfituesve të papërgjegjshëm. Mungesa e monitorimit dhe raportimi i mangët nga përfituesit nuk siguron se mjetet financiare janë shpenzuar për qëllimin e përcaktuar.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve, monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara zbatojnë të gjitha procedurat ligjore me rastin e përzgjedhjes së përfituesve dhe monitorimit dhe raportimit nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A3 - Mangësi në procedurat e prokurimit publik****Gjetja**

Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 57, pika 57.2, përcakton që kontraktimi i konsulentëve individual bëhet përmes procedurave të prokurimit, me kriter të shpërbllimit "Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm". Në pikën 57.14, janë përcaktuar kriteret për vlerësim si: përvoja e këshilltarit, cilësia e metodologjisë së propozuar, kualifikimi, dhe transferimi i dijenisë nëse kërkohet.

Të kontrata dy vjeçare Angazhimi i një konsulenti për shërbime të veçanta lot 1, dhe një konsulenti për shërbime të veçanta lot 2, në vlerë totale 25,440€, të njoftimi për kontratë në nën kriteret për lot 1, nuk ishte përfshirë nën kriteri për cilësinë e metodologjisë së propozuar nga konsulenti. Për lot 2 nuk ishte vendosur asnjë nën kriter në njoftimin për kontratë, dhe se kriter për dhënie të kontratës ishte caktuar çmimi më i ulët, e jo çmimi ekonomikisht më i favorshëm, derisa në dosjen e tenderit ishin përcaktuar nën kriteret dhe kriteri i dhënies tenderi ekonomikisht më i favorshëm.

Në raportin zyrtar të vlerësimit të tenderëve nuk janë prezantuar nën kriteret në bazë të të cilave janë vlerësuar me pikë kandidatët/aplikuesit, por janë mbajtur në një dokument tjetër intern. Në ofertën e konsulentit për lot 2 mungonte dokumenti identifikues, e që ishte kriter i kërkuar në njoftimin për kontratë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve të brendshme të mangëta, derisa sipas zyrës së prokurimit kjo ka ndodhur për shkak se nuk ishin të informuar mjaftueshëm për kërkesat e kësaj procedure të aplikuar.

- Ndikimi** Mangësitë e identifikuar mund të rezultojnë me mos arritjen e qëllimit për të cilën është realizuar kjo formë e kontraktimit.
- Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë që procedura e prokurimit për angazhimin e konsulentëve të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara me nenin 57 të Rregullores për prokurimin publik, dhe se komisioni vlerëson ofertat në bazë të kriterëve të përcaktuara me dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Urdhër blerjet pas pranimit të faturave

- Gjetja** Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike, neni 22, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallrave dhe shërbimeve apo punëve, dhe pastaj pranohet fatura.

Në gjashtë (6) pagesa për investime kapitale dhe katër (4) pagesa për mallra e shërbime në vlerë totale 428,015€ urdhërblerjet ishin përgatitur pas pranimit të faturave.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve të pamjaftueshme në zbatimin e hapave për kërkesë dhe lëshim të urdhërblerjes.

- Ndikimi** Përgatitja e urdhërblerjeve me vonesë krijon paqartësi në përmbushjen e kushteve kontraktuale për realizim dhe liferim me kohë të mallrave dhe shërbimeve apo punëve.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se pranimi i mallrave dhe shërbimeve apo punëve ti paraprijë urdhërblerja.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore**Gjetja**

LMFPP në nenin 40.1 përcakton që kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë totale 208,913 . Prej tyre borxhi kryesor ishte 180,396 , derisa 28,516 ishin pagesa shtesë në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore.

Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të kërkesave për pagesë si rezultat i vendimeve për shpronësim.

Ndikimi

Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxheti sipas planifikimeve, duke krijuar kosto shtesë si rezultat i procedurave gjyqësore.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos përmbushjen e obligimeve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në pagesën me kohë të obligimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Vonesa në pagesën e obligimeve****Gjetja**

LMFPP dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës. LMFPP në nenin 37.1 përcakton që OB nuk ndërmer asnjë obligim gjate vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara.

Katër (4) fatura në vlerë totale 73,843€ janë realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimi të faturës. Vonesat ishin nga 17 deri në 63 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare.

Ndikimi

Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e ankesave dhe vonesave në realizim të kontratave nga kontraktuesit.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet financiare të jenë siguruar paraprakisht, dhe se faturat e kontraktuesve të

paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në zbritjet e bazës tatimore për banimin primar dhe të dhënat në databazën e tatimi në pronë

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajtshme, neni 11 përcakton që personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000 nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. UA nr. 03/2021 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1, kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.

Nga analiza e bazës së të dhënave të tatimit në pronë, kemi identifikuar 635 raste (banime primare) për të cilët nuk është llogaritur zbritja nga baza tatimore prej 15,000€, në njëmbëdhjetë (11) raste zbritja është aplikuar dy (2) herë, dhe në një (1) rast zbritja është aplikuar 3 herë.

Gjithashtu, në bazën e të dhënave 892 tatimpagues nuk kanë të evidentuar numrin e letërnjoftimit.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në përditësimin dhe aplikimin e zbritjeve për banim parësor, dhe azhurnimin e informatave për tatimpaguesit në bazën e të dhënave për tatimin në pronë.

Ndikimi

Mangësitë në llogaritjen e bazës tatimore ndikojnë në kalkulim të pasaktë të tatimit në pronë. Mos përditësimi i informatave të tatimpaguesve, pamundëson informacionin e saktë me qëllim aplikimin e zbritjeve e mundshme për vendbanim parësorë të lejuar.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se bëhet përditësimi i të dhënave të tatimpaguesve në Protax.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si: mallra e shërbime, subvencione, si dhe investime kapitale.

Çështja A5 - Mangësi në menaxhimin e kontratave publike

Gjetja

Me specifikacionin teknik të kontratave publike është përcaktuar sasia e punëve dhe kushtet tjera që kontraktuesi duhet ti realizoj. Në secilën kontratë publike përcaktohet afati kohor i fillimit dhe përfundimit të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve. Ndërlidhur me këtë, neni 70.10, i Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, përcakton që pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës (MK), i njëjti duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës.

Nga auditimi i pagesave për projektet kapitale kemi identifikuar se:

- Te kontrata për Ndërtimin e shtigjeve të ecjes në Gadime faza II, në vlerë 267,759€, për shkak të mos planifikimeve adekuata dhe zgjidhjes së kontesteve pronësore para se projekti të filloj, menaxhimin joadekuat të kontratës, dhe mos përmbushjes së duhur të punimeve dhe furnizimeve nga kontraktuesi, kishin mbetur të porealizuara dhe të papaguara pozicione në vlerë 45,172€. Projekti ishte përfunduar me dy javë vonesë, edhe pas zgjatjes së planit dinamik për dy muaj nga plani paraprak.
- Kontrata e punëve për Ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën „Ismajl Luma”, në vlerë 248,226€, me gjithë shtyrjen e planit dinamik duhej të përfundonte në fund të muajit janar 2024, deri në muajin maj 2024 projekti ishte realizuar vetëm 32% e punimeve.
- Të kontrata publike kornizë Hartimi i projekteve detale me 3 llote, shërbimet e hartimit të projekteve për renovimin e shkollave në vlerë 12,760€ ishin realizuar me 73 ditë vonesë. Nuk janë aplikuar penalet për ditët në vonesë.

Gjithashtu, në modulën e menaxhimit të kontratave publike në platformën e-Prokurimi, për 14 kontrata të dhënat nuk janë azhurnuar nga menaxherët e kontratave dhe nuk është bërë vlerësimi i performancës së kontratave.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta në planifikim dhe menaxhim të kontratave publike.

Ndikimi

Mangësitë aktuale në realizim të kontratave mund të ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës, si dhe mos përfitimet me kohë të qytetarëve në shfrytëzimin e këtyre projekteve.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë se inicimit të projekteve kapitale ti paraprijë një planifikim i mirëfilltë nga njësi kërkuese dhe se monitorimi dhe zbatimi i projekteve kapitale të realizohet sipas paramasës dhe planit dinamik të përcaktuar me kontratë. Në rastet kur kontraktuesit nuk realizojnë punimet dhe furnizimet me kohë dhe sipas paramasës të aplikohet ndalesa e

sigurisë së ekzekutimit dhe aplikimi i penaleve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në RFV e vitit 2023 në total janë 5,006,496€. Saldo e të arkëtueshmëve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë, si dhe taksat nga shfrytëzimi i pronave komunale.

Çështja B3 - Rritja e llogarive të arkëtueshme

Gjetja	<p>Rregulla financiare nr. 03/2010 për të hyrat, rregullon kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.</p> <p>Llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë kanë shënuar rritje prej 7% apo 303,218€ në krahasim me vlerën e të arkëtueshmëve nga viti 2022, derisa të qiratë komunale kemi rritje për 4% apo 3,117€ në krahasim me vitin paraprak.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave vetanake.</p>
Ndikimi	<p>Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.</p>
Rekomandimi B3	<p>Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	19,779,849	24,587,488	22,586,465	16,777,728	17,808,414
Grante Qeveritare - Buxheti	17,441,859	18,876,083	18,230,763	14,313,829	15,027,299
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	176,635	69,971
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,508,301	862,499	685,145	665,239
Të hyrat vetanake	2,337,990	2,337,990	2,224,126	1,413,357	1,690,784
Donacionet vendore	0	757	0	6,762	34,001
Donacionet e jashtme	0	1,864,357	1,269,077	182,000	321,119

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 4,807,639€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 1,434,224€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 1,508,301€, si dhe donacioneve në vlerë 1,865,114€.

Komuna ka shpenzuar 22,586,465 ose 92% të buxhetit përfundimtar të vitit 2023, me një përmirësim prej 5% në krahasim me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Në vitin 2023 Komuna ka përfituar 300,059 të hyra nga gjobat në trafik dhe 46,345 nga gjobat e gjykatave. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	19,779,849	24,587,488	22,586,465	16,777,728	17,808,414
Pagat dhe mëditjet	9,924,708	11,358,932	11,333,932	9,483,910	10,075,472
Mallrat dhe shërbimet	3,013,000	3,040,011	2,990,997	2,080,588	1,742,262
Komunalitë	370,000	381,395	379,853	352,924	266,640
Subvencionet dhe transferet	962,000	990,778	965,965	893,179	445,909
Investimet Kapitale	5,510,141	8,816,372	6,915,717	3,967,128	5,278,131


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për Paga e Mëditje është rritur 1,434,224 . Rritja është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerën 1,419,539 , dhe pranimeve në shumën 14,685 me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të dedikuara për shtesat sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
- Buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve është rritur për 27,011 . Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 26,994 , dhe nga donacionet e pashpenzuara nga vitet e kaluara në vlerë 18 .
- Buxheti për Shërbime Komunale është rritur për 11,395 nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar.
- Buxheti për Subvencione dhe Transfere është rritur për 28,778 nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar.
- Buxheti për Investime kapitale është rritur për 3,306,231 . Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 1,441,134 , dhe nga granti për performancë komunale në vlerë 1,865,096 .

Programi i Investimeve Publike përfshin 59 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për infrastrukturë rrugore, parking, parqe, ujësjellës, fusha sportive, rregullim të lumenjve, kanalizim, ndërtim dhe renovim të objekteve arsimore dhe shëndetësore, makineri, pajisje, etj.

Komuna e Lipjanit ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 14,685 , të cilat janë shfrytëzuar për shtesa nga sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2023 ishin 3,176,753€. Ato kanë të bëjnë kryesisht nga të hyrat nga tatimi në pronë (46%), taksat për lejet ndërtimore, taksat administrative, të hyrat nga qiraja, participimet, dhe taksat tjera komunale.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	2,337,990	2,337,990	3,176,753	2,159,619	2,128,666
Të hyrat tatimore	1,401,362	1,401,362	1,461,266	1,237,277	1,078,479
Të hyrat jo tatimore	936,628	936,628	1,715,487	921,548	1,049,187
Të hyrat tjera	0	0		795	1,000

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Lipjanit ka rezultuar me 10 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, si dhe ka përgatitur raport periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2022. Raporti i auditimit për vitin 2022 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, pesë (5) rekomandime janë zbatuar; një (1) ishte në proces, dhe (3) nuk janë zbatuar, dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr.	Kategoria	Detajet e rekomandimit	Progresi	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara për ndarjen e bursave të janë në pajtueshmëri me udhëzimin administrativ nga ministria përgjegjëse.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë marrjen masave të nevojshme në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, rritjen e kujdesit, në mënyrë që të bëhet përzgjedhja e kandidatëve të merituar me më së shumti pikë.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë, për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë lehtë të qasshme, për tu identifikuar në regjistrat përkatës të pasurive komunale, si dhe për pasuritë e regjistruara si të grupuara të bëjë rivlerësimin e tyre.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë, që të ketë fondet e nevojshme për kategorinë e pagave, planifikim të mirëfillt si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Ka vazhduar përgatitja e urdhërblërje pas pranimit të faturave.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për hartimin e planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren 04/2017 për Mbështetje Financiare për kohën e hapjes së thirrjeve dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
7.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.	Nuk është i aplikueshëm më.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste dhe ruajtjen e dokumentacionit të tyre.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatim
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik. Po ashtu, të forcojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.	Kemi ulje të nivelit të borxheve të papaguara.	Pjesërisht i zbatuar

10.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës do të rrisin kujdesin në klasifikimin e drejtë të detyrimeve në Pasqyra Financiare Vjetore.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
-----	-----------------------	---	-------------------------	-----------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit




Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPJAN
01 Nr. Br. 470/04-24184
Data/Date 05.06.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të KIC-Lipjan për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunitetit të Lipjanit

Data: 30.05.2024,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare' duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet', duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ^a Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- η Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLICA OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
LIPJAN MUNICIPALITY

Komuna e Lipjanit
Zyra e Kryetarit

Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit të zyrës kombëtare të Auditimit për PVF të vitit 2023

Baza ligjore	Të Gjeturat në Raportin e ZAP	Rekomandimet	Zyrtari përgjegjës për implementimin e rekomandimit	Aktivitetet e përcaaktuara për implementimin e Rekomandimit	Afati kohor i përbushjes
A1	Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim, neni 21, pika 4, specifikon se pas pranimit të kërkesës së pakompletuar për leje ndërtimore për ndërtim të kategorisë II ose III, organi kompetent brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve e njofton aplikuesin për hapat e nevojshëm që duhet të ndërmerr që ta komplettoj kërkesën. Nëse përmirësimet janë të nevojshme, aplikuesi i bën përmirësimet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve për ndërtimet e kategorisë II dhe III. Nëse aplikuesi nuk i përmbahet afateve pas njoftimit, organi kompetent mundet ta refuzoj kërkesën. Kjo kohë e shqyrtimit nuk do	Rekomandimi-A1: Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim shqyrtohen brenda afateve kohore ligjore, dhe se kërkesat për leje mjedisore të bëhen nga vet aplikuesit.	Zyrtaret e DPM	Vonesat në shqyrtimin e lëndëve për leje ndërtimore ndikohen nga disa faktorë. Për shkak të procedurave, disa lëndë është e pamundur të përfundohen brenda afateve ligjore. Megjithatë DPJMM do të angazhohet të respektoj maksimalisht afatet ligjore.	Ky rekomandim do të zbatohet nga muaji korrik 2024

09

<p>të ndikoj në afatin e organit kompetent për lëshimin e lejes sipas paragrafit 3. të këtij neni.</p> <p>Ligji Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, neni 14, pika 3.1, specifikon se nëse organi kompetent vlerëson se aplikacioni është i kompletuar dhe ndërtimi pa leje kualifikohet për legalizim siç parashihet me këtë ligj, organi kompetent lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në kadastrë dhe në RDPP brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas dorëzimit të aplikacionit të kompletuar nga aplikuesi.</p> <p>UA nr. 01/2017 për dhënien e lejes ndërtimore, neni 6, pika 1, specifikon se, për marrjen e leje mjedisore, aplikuesi duhet t'i dorëzoj komunës kërkesën të cilës i bashkëngjitet raporti për leje mjedisore.</p> <p><u>Nga auditimi i lëndëve kemi identifikuar se:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Një kërkesë për leje ndërtimore kishte vonesa në shqyrtimin e aplikacionit për 40 ditë, derisa njoftimi për plotësim dokumentacioni ishte me 20 ditë vonesë. • Shqyrtimi i një kërkesë për legalizim kishte vonesa gati 3 vite, dhe • Për leje mjedisore komuna nuk aplikon kërkesën nga pala ashtu siç kërkohet me procedurat dhe udhëzuesin përkatës, por praktikon një kërkesë/dokument të brendshëm të përpiluar dhe nënshkruar nga vet zyrtarët e komunës e jo edhe nga aplikuesi. <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të mangëta dhe mungesës së personelit të mjaftueshëm në shqyrtimin e lëndëve.</p> <p>Ndërkimi Mangësitë aktuale ndikojnë negativisht në përbushjen me kohë të shërbimeve komunale ndaj bizneseve dhe qytetarëve.</p>	<p>Parashirimi i kërkesave për Leje Mjedisore Komunale që nga mesi i vitit 2023 bëhet drejtpërdrejt në Komisionin përkatës.</p> <p>Një numër i konsiderueshëm i lëndëve të pashqyrtuara për legalizim është grumbulluar që nga viti 2018. DPUMM nuk ka pasur kapacitete për shqyrtimin e tyre. Tani këtë numër e kemi sjellur në minimum – përkatësisht edhe 24 lëndë të pashqyrtuara – qershor 2024.</p> <p>Për lëndët që pranohen aktualisht – të gjitha shqyrtohen brenda afateve ligjore.</p>	<p>Ky rekomandim është i zbatuar.</p> <p>Ky rekomandim do të zbatohet nga muaji korrik 2024</p>
	<p>Rekomandimi -A2: Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve, monitorim dhe zbatim të</p>	<p>DKRS do të kujdeset që për të gjitha vlerësimet puna e komisionit për vlerësimin ndajjes së subvencioneve do të</p>
<p>A2</p>	<p>Në thirrjen publike nr.05-453/01-38765, të datës 27.07.2023, dhe udhëzimin për aplikantët, është kërkuar nga aplikuesit formulari i deklarimit për mungesë të financimit të dyfishtë, vërtetimin nga ATK që vërteton se organizata nuk ka borxh publik</p>	

<p>apo ka ndonjë marrëveshje për shlyerjen e obligimeve, para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara.</p> <p>Në vendimet për ndarjen e mjeteve financiare për përfutuesit individual nr. 453/01-41957, 400/04-41795 dhe 400/04-66447, neni 3, përcaktohet që përfutuesi duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat t'i dorëzojë në DKRS më së largu deri me 25.12.2023 respektivisht 31.01.2024.</p> <p>Te subvencionimi i klubit sportiv të volejbollit "Ulpiana" në vlerë 8,000€, përfutuesi kishte ofruar vërtetimin tatimor me afat të skaduar, në deklaratën mbi financimin e dyfishitë nuk është specifikuar (shenjëzuar) asnjëri nga opsionet nëse ka përfutuar financim për të njëjtin projekt apo jo, dhe se vërtetimin nga gjykata e ka ofruar pas nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Gjithashtu, tre përfutues individual që ishin financuar nga komuna në vlerë total 5,300€, nuk kishin dorëzuar në komunë raportet narrative dhe financiare për shumën e përfutuar.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme gjatë vlerësimit të kërkesave për subvencionim, si dhe papërgjegjshmëria e zyrtarëve përgjegjës për të mbikëqyrur implementimin dhe raportimin nga OJQ-të përfutuese.</p>	<p>projekteve të subvencionuara zbatojnë të gjitha procedurat ligjore me rastin e përzgjedhjes së përfutuesve dhe monitorimit dhe raportimit nga përfutuesit.</p>	<p>DRSK</p>	<p>zbatohet rregullat sipas ligjit, rregullores dhe kritereve të publikuara me rastin e thirrjeve publike për aplikim nga OJQ-të.</p> <p>Asnjë lëshim teknik nga ana e komisionit nuk do të lëshohet.</p> <p>Nga muaji korrik 2024</p>
---	---	-------------	--

<p>Rregullorja nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 57, pika 57.2, përcakton që kontraktimi i konsulentëve individual bëhet përmes procedurave të prokurimit, me kriter të shpërbërimit "Tenderi Ekonomikisht më i favorshëm". Në pikën 57.14, janë përcaktuar kriteret për vlerësim si: përvoja e këshilltarit, cilësia e metodologjisë së propozuar, kualifikimi, dhe transferimi i dijenisë nëse kërkohet. Të kontrata dy vjeçare Angazhimi i një konsulentit për shërbime të veçanta lot 1, dhe një konsulentit për shërbime të veçanta lot 2, në vlerë totale 25,440€, të njoftimi për kontratë në nën kriteret për lot 1, nuk ishte përfshirë nën kriteri për cilësinë e metodologjisë së propozuar nga konsulentit. Për lot 2 nuk ishte vendosur asnjë nën kriter në njoftimin për kontratë, dhe se kriter për dhënie të kontratës ishte caktuar çmimi më i ulët, e jo çmimi ekonomikisht më i favorshëm, derisa në dosjen e tenderit ishin përcaktuar nën kriteret dhe kriter i dhënies tenderi ekonomikisht më i favorshëm.</p> <p>Në raportin zyrtar të vlerësimit të tenderëve nuk janë prezantuar nën kriteret në bazë të të cilave janë vlerësuar me pikë kandidatët/aplikuesit, por janë mbajtur në një dokument tjetër intern. Në ofertën e konsulentit për lot 2 mungonte dokumenti identifikues, e që ishte kriter i kërkuar në njoftimin për kontratë.</p>	<p>Rekomandimi -A3: Kryetari duhet të sigurojë që procedura e prokurimit për angazhimin e konsulentëve të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara me nenin 57 të Rregullores për prokurimin publik, dhe se komisioni vlerëson ofertat në bazë të kriterëve të përcaktuara me dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.</p>	<p>Drejtori a e Prokuri mit</p>	<p>Drejtonia e prokurimit do të ketë kujdes dhe do të sigurohet se Njoftimet e Publikuara për Kontratë dhe DT për aktivitetin e prokurimit të iniciuar, do të jenë identike njëra me tjetren, në rast se ndodhe një mospërputhje që nuk korespondon njëra me tjetren në do të korrigjojm me kohe sipas formularit standard B54, sipas KRPP-se. DSHPS respektivisht Zyrtari Autorizues ka ndërmarrë të gjitha hapat për sigurimin e zotimit paraparak të mjeteve. Kjo ka ndodhur me efekt të menjëhershëm dhe do të vazhdoj.</p> <p><i>DSHPS do të angazhohet në sigurimin e një planifikim të mirëfilltë si dhe monitorimi dhe zbatimin i projekteve kapitale të realizohet sipas paramasës dhe planit dinamik të përcaktuar me kontratë. Poashtu, DSHPS do të kërkoj nga secili menaxher menjëherë mbas njoftimit për emerim si menaxher i kontrates të bëjë planifikimin e menaxhimit të kontratave duke përcaktuar fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Poashtu, do të siguroj se</i></p>	<p>Gusht 2024</p>	<p>Korrik 2024</p>
--	--	---	--	-------------------	--------------------

					<i>menaxheret e kontratave azhurnojnë dhe bëjnë vlerësimin e performancës së kontratave në modulën e menaxhimit të kontratave publike në platformën e-Prukurimi.</i>	
81	<p>Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike, neni 22, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhër-bleerja, bëhet pranimiti i mallrave dhe shërbimeve apo punëve, dhe pastaj pranohet faktura.</p> <p>Në gjashtë (6) pagesa për investime kapitale dhe katër (4) pagesa për mallra e shërbime në vlerë totale 428,015€ urdhërblertjet ishin përgatitur pas pranimit të faturave.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pamjaftueshme në zbatimin e hapave për kërkesë dhe lëshim të urdhërblertjes.</p>	<p>Rekomandimi -B1:</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se pranimiti i mallrave dhe shërbimeve apo punëve të paraprirë urdhërblertja.</p>	ZKF – zyrtarët Autorizues – Drejtori dhe Prokurorët	Drejtorja e prokurimit do të njoftoj të gjitha njesitë kërkuese (nën programet nuxhetore) me një shkresë, përmes së cilës do të kërkojmë nga njesitë e kërkeses përmes menaxhereve të kontratave të evitohet pranimiti e faturave para urdhër-blertjes.	Korrik 2024	
82	<p>LMFPP në nenin 40.1 përcakton që kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.</p> <p>Si rezultat i procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë totale 208,913 . Prej tyre borxhi kryesor ishte 180,396 , derisa 28,516 ishin pagesa</p>	<p>Rekomandimi -B2:</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos përmbushjen e obligimeve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në pagesën me kohë të obligimeve</p>	Avokati publik	Pranimiti i padive për shpronësim e pronave nga Komuna është i ndërlidhur me procesin e vlerësimit të pronave të cilat kryhen nga komisioni i vlerësimit të patundshëmive në kuadër të DTP, MFT, në këtë rast Komuna nuk ka informatë lidhur me shumën e vlerësimit të pronës për një metër katror, edhe pas pranimit të vlerësimit nga DTP –MFT, sipas procedurave të parapara ligjore Komuna si palë e paditur	Në vazhdimësi	

	<p>shtesë në emër të kamatave, tarifave të përbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore.</p> <p>Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të kërkesave për pagesë si rezultat i vendimeve për shpronësim.</p>		<p>duket të parqesë gjykatës ankesë, kështu që deri sa kalojnë këto afate normalisht që rritet borghi si rezultat i llogaritës së interesit nga gjykatësi përbarimor.</p> <p>Ne gjatë vitit 2024, do të kërkojmë përgjegjësi nga menaxherët e kontratave nëse fakturat vonohen për pagesë, si rezultat i vonesave në kompletimin e lëndëve për pagesë, në rastet e pranimi të faturave me vonesë për shpenzimet e karburanteve, do të bazohemi në datën e protokollimi të faturave kur është pranuar nga Komuna, pasi që OE, me vonesë pranojnë çmimet e berzes nga agjencioni i prokurimit.</p>	<p>Prej Muajit Gusht 2024</p>
C1	<p>LMFPP dhe Rregulla financiare Nr.01/2013/MF për shpenzimin e parave publike, përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës. LMFPP në nenin 37.1 përcakton që OB nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara.</p> <p>Katër (4) fatura në vlerë totale 73,843€ janë realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimi të faturës. Vonesat ishin nga 17 deri në 63 ditë. Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e nevojshme financiare.</p>	<p>Rekomandimi -C1:</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet financiare të jenë siguruar paraprakisht, dhe se fakturat e kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave</p>	<p>ZKF-DBF</p> <p>Menaxherët e kontratave – zyrtarët autorizues</p>	
A4	<p>Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajtshme, neni 11 përcakton që personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejon zbritja prej 15,000 nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. UA nr. 03/2021 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1, kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik.</p> <p>Nga analiza e bazës së të dhënave të tatimit në pronë, kemi identifikuar 635 raste (banime primare) për të cilët nuk është llogaritur zbritja nga baza</p>	<p>Rekomandimi -A4:</p> <p>Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me</p>	<p>Sektori i Tatimit në Pronë -DTP-MFT</p>	<p>Korrik – Dhjetor 2024</p>

<p>tatimore prej 15,000€, në njëmbëdhjetë (11) raste zbritja është aplikuar dy (2) herë, dhe në një (1) rast zbritja është aplikuar 3 herë. Gjithashtu, në bazën e të dhënave 892 tatimpagues nuk kanë të evidentuar numrin e letërnjoftimit. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontroleve të dobëta në përditësimin dhe aplikimin e zbritjeve për banim parësor, dhe azhurnimin e informatave për tatimpaguesit në bazën e të dhënave për tatimin në pronë.</p>	<p>vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se bëhet përditësimi i të dhënave të tatimpaguesve në Protax.</p>	<p>Administratës, Sektori i Ofiqarisë që ti identifikojmë të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk e kanë ID valide të marrim këto të dhëna nga sistemi i dhe të validojmë në programin e tatimit në pronë protax. Po ashtu kemi publiku njoftimin që të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk e kanë ID valide, mos tu kryhet shërbimi në tatim në pronë përdërisa nuk i sjellin ID. Sipas Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajtshme, të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk është ID valide nuk përfitojnë nga zbritja primare, dhe tatimpaguesit të cilët nuk janë banorë të Republikës së Kosovës dhe rastet kur tatimpaguesit kanë pronat primare të komunat tjera, ata për pronat sekondare nuk përfitojnë nga zbritja.</p>	<p>Prej Muajit Shtator 2024</p>	
<p>83</p>	<p>Rregulla financiare nr. 03/2010 për të hyrat, rregullon kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake. Logaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë kanë shënuar rritje prej 7% apo 303,218€ në krahasim më vlerën e të arkëtueshmëve nga viti 2022, derisa të qiratë komunale kemi rritje për 4% apo 3,117€ në krahasim me vitin paraprak. Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në mbledhjen e të hyrave vetanake.</p>	<p>Rekomandimi B3 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.</p>	<p>DEZH – sektori i tatimit në pronë Zyra ligjore</p>	<p>Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim do të njoftoj sektorin pronësor lidhur me shkallën e arkëtimeve, në mënyrë që të merren masa ndaj shfrytëzuesve të proanve komunale që kanë vonesa në pagesa. Sektori tatimi në pronë, në vazhdimësi sipas kompetencave që ka dërgon vërejtjet dhe vërejtjet e fundit tatim paguesve, për tatimpaguesit e mëdhenjë do të merren veprime për bllokimin e llogarive bankare.</p>

<p>Me specifikacionin teknik të kontratave publike është përcaktuar sasia e punëve dhe kushtet tjera që kontraktuesi duhet të realizojë, Në secilin kontratë publike përcaktohet afati kohor i fillimit dhe përfundimit të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve. Ndërlidhur me këtë, neni 70.10, i Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, përcakton që pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës (MK), i njëjti duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës.</p> <p>Nga auditimi i pagesave për projektet kapitale kemi identifikuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Te kontrata për Ndërtimin e shtigjeve të ecjes në Gadime faza II, në vlerë 267,759€, për shkak të mos planifikimeve adekuate dhe zgjidhjes së kontesteve pronësore para se projekti të fillojë, menaxhimit joadekuat të kontratës, dhe mos përbushjes së duhur të punimeve dhe furnizimeve nga kontraktuesi, kishin mbetur të përcaktuara dhe të papaguara pozicione në vlerë 45,172€. Projekti ishte përfunduar me dy javë vonësë, edhe pas zgjatjes së planit dinamik për dy muaj nga plani paraprak. • Kontrata e punëve për Ndërtimin e sallës së sporteve në shkollën „Ismajil Luma”, në vlerë 248,226€, me gjithë shtyrjen e planit dinamik duhej të përfundonte në fund të muajit janar 2024, deri në muajin maj 2024 projekti ishte realizuar vetëm 32% e punimeve. 	<p>Rekomandimi -A5: Kryetari duhet të sigurojë se inicimit të projekteve kapitale të paraprijë një planifikim i mirëfilltë nga njësia kërkuese dhe se monitorimi dhe zbatimi i projekteve kapitale të realizohet sipas paramasës dhe planit dinamik të përcaktuar me kontratë. Në rastet kur kontraktuesit nuk realizojnë punimet dhe furnizimet me kohë dhe sipas paramasës të aplikohet ndalesa e sigurisë së ekzekutimit dhe aplikimi i penaleve.</p>	<p>Menaxherët e kontratave – Drejtori a për Infrastruktura publike</p>	<p>Gjatë këtij viti, menaxherët e kontratave do të angazhohen që plani e menaxhimit të kontratave të publikojnë me kohë në E-prokurimi, si dhe të bashkangjesisin faturat dhe vlerësimin e performances se OE.</p> <p>Menaxherët e kontratave në rastet e mos kryetjes së problemeve për shkak të defekteve në projektim, ndaj OE do të zbatojnë ndalesa për pozicionet e pa kryera, ndërsa në rastet të vonësive do të aplikojnë ndalesa –penale sipas kontratës së nënshkruar</p>	<p>Prej Muajit Gusht 2024</p>
<p>A5</p>				

për renovimin e shkollave në vlerë 12,760€ ishin realizuar me 73 ditë vonesë. Nuk janë aplikuar penalet për ditët në vonesë.
Gjithashtu, në modulën e menaxhimit të kontratave publike në platformën e- Prokurimi, për 14 kontrata të dhënat nuk janë azhurnuar nga menaxherët e kontratave dhe nuk është bërë vlerësimi i performancës së kontratave.

01.07.2024

Kordinatori :Visar Kozhani

Miratoi : Kryetari i Komunës

Z. Imri Ahmeti

